

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Have Haliti, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarit A.R., nga fshati ..., Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së PTH-DKR në Ferizaj, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj P.nr.78/2016, të datës 13.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.04.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohen si të pabazuara ankesa e PTH-DKR në Ferizaj, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, P.nr.78/2016, të datës 13.12.2017, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj P.nr.78/2016, të datës 13.12.2017, i akuzuari A.R., është liruar nga akuza për veprën penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK, për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale, nga neni 364 par. 1 nën par. 3.1 të KPP-së.

I dëmtuari N.M. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-Prokuroria Themelore-DKR në Ferizaj, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovojë ankesën si të bazuar ta anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen penale ta kthejë në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj PPA/I.nr.114/18, të dt.23.03.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e PTH-DKR në Ferizaj, ka propozuar që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi të anulohet dhe çështjen penale ta kthejë në rigjykim dhe vendim.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP, në këtë çështje penale nuk caktoi seancën e kolegjit, për arsye se kemi të bëjmë me aktgjykim lirues dhe mbajtja e seancës së kolegjit nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, duke vlerësuar pretendimet ankimore të PTH-DKR në Ferizaj, edhe sipas detyrës zyrtare, e bashkë me te edhe aktgjykimin e ankimuar, e duke marr parasysh edhe mendimin me shkrim të paraqitur nga ana e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës gjeti se:

Ankesat e PTH-DKR në Ferizaj, është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

PTH-DKR në Ferizaj, në ankesën e saj pretendon se gjykata ka marrë parasysh vetëm mbrojtjen e të akuzuarit A.R., dhe nuk ia ka falë besimin dëshmisë të dëmtuarit i cili në mënyrë ka treguar tërë ngjarjen lidhur me ekskursion dhe pagesat e bëra nga ana e të akuzuarit. Gjykata nuk ia ka falur besimin pronarit të hotelit "NN", G.K., i cili ka vërtetuar faktin se stafi i shkollës "Faik Konica", në Ferizaj, së bashku me drejtorin kanë negociuar lidhur me çmimin për akomodimin e nxënësve në hotel, sipas dëshmisë pagesat për akomodimin e nxënësve janë bërë nga vet mësuesit-kujdestarët e klasave. Kjo dëshmi është e kundërt me dëshminë e dëshmitarëve S.A. e M.H., të cilët nuk kanë bërë pagesën për akomodimin e nxënësve në hotelet "NN". Gjykata nuk u ka falë besimin edhe faturave tatimore të cilat janë siguruar në mes ndihmës juridike ndërkombëtare.

Gjykata e Apelit, edhe pse aktgjykimi nuk është e ankimuar, sipas bazës ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sipas detyrës zyrtare aktgjykimin e ankimuar është vlerësuar edhe sipas kësaj baze ankimore, në kuptim të nenit 394 par.1 të KPP, dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe të plota rreth argumentimit se i akuzuari A.R., nuk është kryes i veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota se i akuzuari A.R., që në cilësinë e drejtorit të shkollës, këshilli organizativ i shkollës pas grumbullimit të parave nga nxënësit për ekskursion ia dorëzon të hallat në vlerë prej 28,800.00 Euro, të akuzuarit A.R., e këto të holla, i akuzuari ia dorëzohet N.M., si përfaqësues i NTP "NM", i cili kishte fituar tenderin për transportimin e nxënësve në ekskursion në Republikën e Shqipërisë.

Gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare se çdo nxënës ka pasur për ti paguar nga 90Euro, dhe për 387 nxënës të cilët janë akomoduar në kompleksin turistik "MM", me çmim prej 12 Euro,- një natë për një nxënës, ku për pesë net të agjencisë "NM" Ferizaj, çmimi total i ka kushtuar 23.220.00Euro, e cila mbështetet në aktin e konstatimit të lëshuar nga drejtoria rajonale tatimore në Durrës, se për periudhën kohore sa kanë qëndruar nxënësit në ekskursion prej dt.25.09.2015 deri me dt.30.09.2015, pagesa për secilin person ka qenë 12 Euro, e për pesë net që në total çmimi ka qenë 60Euro, për 387 nxënës e gjithë shuma për pagesë ka qenë 23,220.00Euro dhe gjykata ka dhënë fakte dhe prova se shuma prej 13.360,00Euro, nuk është përvetësuar nga ana e të akuzuarit, e në mbështetje të kësaj janë edhe dëshmitë e dëshmitarëve S.A. dhe M.H., të cilët kanë deklaruar se me dt.28.09.2015, të dëmtuarit N.M., janë dorëzuar edhe 4.410.00Euro, të holla të cilat janë mbledhur ditën kur janë lajmëruar edhe 49 nxënës për të shkuar në ekskursion dhe i njëjti nuk ka pasur fare vërejtje dhe nuk ka përmendur shuma tjera të borxhit, dhe në dorëzimin dhe pranimin e të hollave e ka bërë pa vërejtje dhe pranimin e të hollave vet e kanë nënshkruar, dhe nuk ka ekzistuar asnjë mos marrëveshje mes të akuzuarit dhe të

dëmtuarit. Se i akuzuari nuk është kryes i veprës penale vërtetohet nga raporti i dorëzimit të mjeteve financiare sipas klasave për ekskursion të dt.24.09.2015, ku këshilli organizativ në përbërje prej S.A.t, M.H. dhe S.R., mjetet financiare në shumë prej 28.800.00Euro, të cilat janë pranuar nga kujdestarët e klasave, ia kanë dorëzuar drejtorit të shkollës A.R., të cilin procesverbal e kanë nënshkruar anëtarët dhe drejtori i shkollës. Se i akuzuari nuk është kryes i veprës penale të përvetësimit në detyrë , argumentohet nga faturat dhe shkresa e lëshuar nga kompleksi turistik “MM”, të dt.25.09.2015, në të cilin kompleks turistik janë akomoduar 387 nxënës me çmim prej 12 Euro, nata për një nxënës ku për pesë net të agjencisë “F.-NM”, Ferizaj, çmimi total ka qenë 23.220.00Euro, këtë fakt mbështet edhe akti i konstatimit të inspektorit të kontrollit tatimor ne Durrës, si dhe deklarata e dëshmitarit të pronarit të subjektit “NN”, G.K., i cili ka deklaruar se pagesat e shërbimit turistik janë bërë nga ana e mësuesve , kujdestarëve të klasave të cilët nuk i njeh dhe pagesat janë dhënë kuponët tatimor për secilën pagesë dhe të gjitha janë deklaruar pranë organit tatimor, ku është paguar edhe TVSH-ja, e që mbështetet nga procesverbali dhe kopja e kuponit fiskal, e të gjitha këto mbështeten edhe nga dëshmitarët S.A. dhe M.H..

Gjykata e Apelit, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe pse ankesa në këtë drejtim ka qenë e mangët, nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP.

Pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë është e pabazuar. Nuk është e kontestueshme se në muajin shtator të vitit 2015 shkolla e mesme “Faik Konica”, ka organizuar ekskursion gjashtë ditor për maturantët për në Shqipëri. Nuk është kontestuese se në mes të operatorëve ekonomik, tenderin e ka fituar “F.NM”. Po ashtu nuk është kontestuese se është lidhur kontrata në mes të NTP “NM” dhe “F.NM” dhe shkollës ekonomike “Faik Konica”. Nuk është kontestuese as fakti se është formuar këshilli organizativ S.A., M.H. dhe S.R. dhe janë grumbulluar të hollat nga kujdestarët e klasave dhe pagesa ka qenë 90 Euro dhe gjithsejtë janë mbledhur 28.800.00Euro, po ashtu nuk është kontestues se me dt.28.09.2015, në Durrës i akuzuari ia ka dorëzuar të dëmtuarit edhe 4.410.00Euro, ku është bërë pranimi i këtyre mjeteve, është përpiluar dhe nënshkruar procesverbali e të cilat mjete janë grumbulluar nga 49 nxënës, të cilët ekskursionin e kanë paguar ditën e nisjes së tyre për në Shqipëri.

Nuk është kontestuese se me dt.05.10.2015, A.R., ka shkuar në lokalet e NTP “F.NM” dhe ia ka dorëzuar të dëmtuarit edhe shumën prej 5.050.00Euro. Kontestuese ka mbetur shumë prej 23.400Euro, të cilat mjete i akuzuari ia ka dhënë NTP “NM”, N.M.t, pasi të ketë mbërri me automjetin e N.M.t te hoteli “NN” dhe gjatë dorëzimit të hollave nuk ka qenë prezent askush, ndërsa i dëmtuari ka deklaruar se këto mjete nuk i ka pranuar dhe nuk ka bërë pagesën për shërbime hoteliere, e sipas të dëmtuarit ky është dashur të bënë pagesën shumën prej 13.360.00Euro, e jo shumën prej 23.220.00Euro. Nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari i ka përmbushur të gjitha obligimet ndaj operatorit “F.NM”, për arsye, se sipas faturës të dt.25.09.2015, në kompleksin turistik janë akomoduar 387 nxënës me çmim prej 12 Euro, nata për një nxënës ku për pesë net të agjencisë “F.NM”, Ferizaj, çmimi total ka qenë 23.220.00Euro, këtë fakt e mbështet edhe akti i konstatimit të inspektorit të kontrollit tatimor ne Durrës, si dhe deklarata e dëshmitarit të pronarit të subjektit “NN”, G.K., i cili ka deklaruar se pagesat e shërbimit turistik janë bërë nga ana e mësuesve kujdestarëve të klasave të cilët nuk i njeh dhe pagesat janë dhënë kuponët tatimor për secilën pagesë dhe të gjitha janë deklaruar pranë organit tatimor, ku është paguar edhe TVSH-ja, e që mbështetet nga procesverbali dhe kopja e kuponit fiskal. E kjo mbështet edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve S.A. dhe M.H., kjo gjendje faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit, edhe pse aktgjykimi nuk është e ankimuar , sipas bazës ankimore të shkeljes së ligjit penal , sipas detyrës zyrtare aktgjykimin e ankimuar është vlerësuar edhe sipas kësaj baze ankimore, në

kuptim të nenit 385 par.1 të KPP , dhe ka gjetur se gjykata , drejt ka vepruar e në bazë të provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor ka marrë aktgjykim lirues në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, për arsye se nuk është provuar se akuzuari A.R., ka kryer vepre penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK për të cilën është akuzuar. Të hollat , të cilat kanë qenë objekt i akuzës, i dëmtuari sipas dëshmitarëve dhe provave të cila gjenden në shkresat e lëndës të hollat këto nuk janë vërtetuar. nuk janë përvetësuar nga i akuzuari A.R. ,dhe me asnjë fakt këto nuk janë provon e të cilat janë cek në bazat tjera ankimore . Nga kjo del se gjykata e shkallës së parë, në bazë të asaj të cekur në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje penale, drejt ka aplikuar ligjin penal.

Prandaj, nga arsyet e përshkruara më lartë u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, ndërsa ankesa e PTH-DKR në Ferizaj, të refuzohet si e pabazuar e në bazë të nenit 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.118/2018, me dt.27.04.2018

Procesmbajtësi,

Anëtarët e Kolegjit,

Kryetare e Kolegjit,

Eroll Gashi

Fillim Skoro

Tonka Berishaj

Have Haliti